



**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR
BASHKËPUNIMIN E NDËRSJELLË**

ndërmjet

SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)

Tiranë, Republika e Shqipërisë

dhe

**BASHKISË SË ELBASANIT
Elbasan, Republika e Shqipërisë**

Në mënyrë që të zgjerojnë bashkëpunimin ekzistues, Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe Bashkia Elbasan i bashkohen protokollit të mëposhtëm, mbi bashkëpunimin arsimor, kulturor dhe social. Palët angazhohen të zhvillojnë bashkëpunimin mes tyre në çështjet e mëposhtme:

I. FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Fushat e veçanta të bashkëpunimit ndërmjet Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) dhe Bashkisë së Elbasanit përfshijnë, por nuk kufizohen në këto të mëposhtmet:

1. Trajnime të stafit;
2. Shkëmbime të eksperiencave ndërmjet stafit;
3. Praktika mësimore;
4. Dhënien e bursave të studimit.

II. TRAJNIME TË STAFIT

Në bazë të nevojave të Bashkisë së Elbasanit dhe brenda kapaciteteve të saj, Shkolla e Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër) do të ofrojë trajnime profesionale për stafin e Bashkisë së Elbasanit. Kushtet mbi planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e këtyre kurseve do të përcaktohen nga palët, rast pas rasti.

III. SHKËMBIME TË EKSPERIENCAVE NDËRMJET STAFIT

Palët marrin përsipër që të mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave midis stafeve respektivë, duke organizuar aktivitete të tilla, si seminare, konferenca etj. Palët do të merren vesh paraprakisht për zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

IV. PRAKTIKA MËSIMORE

Në bazë të nevojave të Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër) dhe brenda kapaciteteve të saj, Bashkia e Elbasanit do të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër).

Kushtet për zhvillimin e praktikave mësimore do të përcaktohen me marrëveshje të palëve.

V. DHËNIEN E BURSAVE TË STUDIMIT

Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër), në bazë të kërkesave të Bashkisë së Elbasanit, do të ofrojë tri (3) bursa studimi për anëtarët e stafit të Bashkisë së Elbasanit, në programet master, për çdo vit akademik.

Bursa e studimit përfshin të gjitha shpenzimet në lidhje me aktivitetin mësimor.

Bursa e studimit nuk përfshin shpenzimet e jetesës ose të transportit.

KOHËZGJATJA, PËRTËRITJA, PËRFUNDIMI DHE SHITESAT

Kjo marrëveshje hyn në fuqi që nga momenti i nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh.

Nëse asnjë nga palët nuk njofton palën tjetër, para përfundimit të afatit të mësipërm, marrëveshja mund të ripërtërihet edhe për një periudhë prej 2 (dy) vjetësh.

Ky protokoll është nënshkruar në dy kopje në gjuhën shqipe. Secila palë mban një kopje origjinale të nënshkruar të protokollit.

Z. Qazim SEJDINI
Kryetar
Bashkia e Elbasanit
Elbasan, Shqipëri

Data: 24.10.2013

Dr. Ferdinand GJANA
Rektor
Shkolla e Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër)
Tiranë, Shqipëri

Data: 24.10.2013